



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.05.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Asfalti" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Asfalti" SH.P.K., e dt.07.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 02.05.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 02.05.2025;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Asfalti" SH.P.K., me dt.07.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me Certifikatën për siguri dhe shëndet në punë të prezantuar nga Operatori i rekomanduar për kontratë, është i pa bazuar, sepse i njëjti ka prezantuar certifikatë të lëshuar nga NMA sh.p.k., e cila është e licencuar nga MPMS-ë, dhe në këtë pikë plotëson kërkesën e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

